



Data: 20.06.2018

Ref.: 653/18D

Në mbështetje të; nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16.09.2010), nenit 7 dhe nenit 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 09/2017, datë: 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 56-të, të mbajtur më 11 Qershor 2018, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa Nr. 533/18 H, datë: 29. 05. 2018, e Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së Nr. 531/17 i datës: 06. 07. 2017.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” ka parashtruar kërkesë Nr. 533/18 H, datë: 29. 05. 2018, për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr. 531/17 të datës: 06. 07. 2017, në lidhje me ndryshimin e strukturës së programit të studimit: Gjuhë dhe Shqipe dhe Letërsi (BSc) nga programi tre vjeçar, në program katërvjeçar, respektivisht nga 180 ECTS në 240 ECTS.


Pas shqyrtimit të kërkesës KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së për Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”. Universiteti i Gjakovës ka aplikuar për programin: Gjuhë dhe Shqipe dhe Letërsi (BSc) me 180 ECTS, përmes dorëzimit të aplikacionit përkatës për akreditim si dhe raportit të vetëvlerësimit. Ky program është vlerësuar dhe rekomanduar për akreditim si i tillë nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, përmes vizitës së realizuar me ekspertë ndërkombëtarë me datë: 18.04.2017 si dhe raportit final të ekspertëve bazuar në dokumentacionin përkatës të dorëzuar nga Universiteti si dhe nga të gjeturat gjatë vizitës së ekspertëve.

Ky program është akredituar nga KSHC-së me vendim Nr. 531/17, datë: 06. 07. 2017, si: Gjuhë dhe Shqipe dhe Letërsi (BSc) 180 ECTS, bazuar në kërkesën e Universitetit të Gjakovës, dhe rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve. Sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë, dhe Udhëzimit Administrativ për Akreditim, vlerësimi i programeve bëhet vetëm nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, bazuar mbi dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni i arsimit të lartë. KSHC merr vendim për akreditim bazuar në raportin final të ekspertëve vlerësues ndërkombëtar duke u bazuar në kërkesat e IAL, prandaj KSHC nuk mund të aprovojë një kërkesë të tillë. Duke pasur parasysh arsyet e cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

